

V E N D I M
Nr. 60, datë 23.1.2003

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 372, DATË 25.7.1994 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E MALLRAVE REZERVË
SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 8576, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 372, datë 25.7.1994 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Mallrat rezervë shtetërore administrohen nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Shtetërore, si institucion që varet drejtpërdrejtë prej tij dhe grupohen në mallra rezervë shtetërore të paprekshme, të grupit A, dhe mallra rezervë shtetërore operative, të grupit B.”.

b) Pika 9 ndryshon si më poshtë vijon:

“9. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore ka për detyrë drejtimin ekonomiko-financiar dhe tekniko-organizativ të degëve të rezervës shtetërore, të ushtrojë kontroll mbi veprimtarinë e tyre dhe përgjigjet para Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit për të gjithë veprimtarinë e sektorit të rezervave shtetërore.”.

c) Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të përgatisë rishikimin e misionit, të mënyrës së funksionimit dhe organizimit në tërësi të sistemit të rezervave shtetërore dhe të paraqesë për miratim projektaktet e nevojshme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano